



Ky projekt financohet  
nga Bashkimi Evropian



**PARTNERËT SHQIPËRI**  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

---

# Raporti i monitorimit të Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve

---

**Shqipëria 2019**



# HUBRinor

BALLKANI PERENDIMOR DHE TURQIA

## Hulumtues

Erila Haska

## Kontribues

Ramadan Sopoti

## Grafika dhe Faqosja

Maris Selamaj

Ky raport monitorimi u përgatit si pjesë e projektit WB&T for EmploYouth, financuar nga Bashkimi Evropian. Projekti zbatohet nga Ana and Vlade Divac Foundation (Serbi), Prima Association (Mali i Zi), Association for education Mladiinfo International (Maqedonia e Veriut), Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (Shqipëri) dhe Community Volunteers Foundation (Turqi).

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



# Në brendësi të këtij raporti



## Përmbledhje

Faqe 3



## Të dhëna mbi pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve

Faqe 5



## Krahasim të të dhënave gjatë 4 viteve të monitorimit

Faqe 11



## Rekomandimet për politika dhe çështjet e advokimit

Faqe 12

Partnerët Shqipëri në kuadër të projektit WB&T for EmploYouth të implementuar në partneritet me Fondacionin “Ana I Vlade Divac” në Serbi, Shoqatën për Arsim- MLADIINFO International në Maqedoni, organizatën “Prima” në Mal të Zi dhe “Community Volunteers Foundation” në Turqi publikojnë një raport vjetor monitorimi që synon të vërë në dukje dhe të analizojë situatën në lidhje me pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve në këto 5 vende.

Raporti i monitorimit filloi të botohej në vitin 2016 si pjesë e iniciativës së Youth Bank Hub for WB&T. Raporti i monitorimit është udhëzuesi mbi rekomandimet për politika të bazuara në dëshmi dhe iniciativat advokuese të rrjetit në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve.

Ky raport ofron një përshkrim të shkurtër të të dhënave aktuale mbi pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve në Shqipëri bazuar në një grup indikatorësh të paracaktuar. Duke marrë parasysh që ky është raporti i katërt vjetor, ai ofron një krahasim të rëndësishëm të të dhënave gjatë këtyre katër viteve të monitorimit 2016 - 2019.

Të dhënat e raportit janë rezultat i hulumtimeve dhe kërkesave zyrtare për informacion dërguar institucioneve përgjegjëse siç janë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Instituti Kombëtar i Statistikave dhe Bashkitë Shqiptare.

Raporti shtjellon rekomandimet dhe iniciativat advokuese për veprimet e ardhshme në lidhje me gjendjen e të rinjve në kuadër të pjesëmarrjes politike, sociale dhe ekonomike.

Të dhënat mbi këtë raport janë pasqyruar në Indeksin e Pjesëmarrjes së të Rinjve, të përpunuara nga 5 raportet e vendeve të rrjetit YBH.



---

“Në katër vitet e fundit numri i bashkive që kanë krijuar struktura rinore është rritur me 39.4% ”


---

---

# Të Dhëna Mbi Pjesëmarrjen Politike Të Të Rinjve

| INDIKATORËT                                                                           | TOTALI | FEMËR | MASHKULL | VITI              |
|---------------------------------------------------------------------------------------|--------|-------|----------|-------------------|
| Ministrat e rinj në qeveri                                                            | 0.0%   | 0%    | 0%       | 2019 <sup>1</sup> |
| Zëvendësministrat e rinj në qeveri                                                    | 7.0%   | 3.5%  | 3.5%     | 2019 <sup>1</sup> |
| Deputetët e rinj në parlament                                                         | 4.0%   | 1%    | 40       | 2019 <sup>1</sup> |
| Kryebashkiakë të rinj                                                                 | 0.0%   | 0%    | 0%       | 2019 <sup>1</sup> |
| Mjete on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimarrjen e qeverisë dhe parlamentit | 79.3%  |       |          | 2019 <sup>1</sup> |
| Mjetet on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimarrjen e bashkive                | 66.0%  |       |          | 2019 <sup>1</sup> |
| Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel kombëtar  | 0.0%   |       |          | 2019 <sup>1</sup> |
| Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel lokal     | 57.4%  |       |          | 2019 <sup>2</sup> |

[1] Hulumtim  
[2] Kërkesë për informacion në 61 Bashkitë e Shqipërisë



“Fakti se disa të dhëna  
mbi përfshirjen sociale  
të të rinjve nuk maten  
dhe as nuk përditësohen  
mbetet një çështje për  
t'u adresuar”

# Të Dhëna Mbi Pjesëmarrjen Sociale Të Të Rinjve

| INDIKATORËT                                                                                                                                                                             | TOTALI          | FEMËR | MASHKULL | VITI                   |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|-------|----------|------------------------|
| Të rinjtë në rrezik varfërie                                                                                                                                                            | Nuk ka të dhëna | -     | -        | 2019 <sup>3</sup>      |
| Përqindja e të rinjve të varfër (të rinjtë që jetojnë nën vijën e varfërisë) (Jo i të rinjve të varfër / jo i të rinjve)                                                                | Nuk ka të dhëna | -     | -        | 2019 <sup>4</sup>      |
| Të rinjtë në burgje                                                                                                                                                                     | 34.8%           | 0.3%  | 35.4%    | 2019 <sup>5</sup>      |
| Të rinjtë pjesë e sistemit të mbrojtjes sociale (të cilët marrin mbështetje financiare nën sistemin e mbrojtjes sociale) pjesëtuar me të rinjtë që janë në sistemin e mbrojtjes sociale | Nuk ka të dhëna |       |          | 2019 <sup>6</sup>      |
| Braktisja e shkollës së mesme                                                                                                                                                           | 2.6%            | 1.15% | 4.27%    | 2018-2019 <sup>7</sup> |
| Të rinjtë e regjistruar në arsimin e lartë                                                                                                                                              | 59.5%           | 71.3% | 47.7%    | 2019-2020 <sup>1</sup> |
| Të rinjtë e diplomuar në arsimin e lartë                                                                                                                                                | 26.7%           | 29.7% | 22.4%    | 2018-2019 <sup>1</sup> |
| Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve në arsimin formal dhe arsimin joformal apo trajnimet gjatë 4 javëve të fundit <sup>8</sup>                                                          | 35%             | 37.9% | 32.1%    | 2019-2020 <sup>3</sup> |

[3] Kërkesë për informacion në Institutin Kombëtar të Statistikave

[4] Partnerët Shqipëri i dërguan një kërkesë për informacion Institutit Kombëtar të Statistikave, por ata u përgjigjën se këto të dhëna nuk maten

[5] Kërkesë për informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

[6] Partnerët Shqipëri i dërguan një kërkesë për informacion Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por Ministria u përgjigj se ata nuk e kanë një informacion të tillë.

[7] Kërkesë për informacion Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë

[8] Instituti Kombëtar i Statistikave, 2020, Tregu i Punës 2019

---

“2019 shënon numrin më  
të ulët të të rinjve në  
burgje gjatë këtyre 4  
viteve të monitorimit”


---



# Të Dhëna Për Pjesëmarrjen Ekonomike Të Të Rinjve

| INDIKATORËT                                                                 | TOTALI | FEMËR  | MASHKULL | VITI               |
|-----------------------------------------------------------------------------|--------|--------|----------|--------------------|
| Norma e NEET                                                                | 26.6%  | 28.90% | 24.30%   | 2019 <sup>9</sup>  |
| Shkalla e papunësisë së të rinjve                                           | 21.5%  | 21.70% | 21.30%   | 2019 <sup>8</sup>  |
| Shkalla e papunësisë afatgjatë së të rinjve                                 | 11.5%  | 8.90%  | 13.70%   | 2019 <sup>8</sup>  |
| Shkalla e pjesëmarrjes së forcës punëtore të të rinjve                      | 52.5%  | 45.60% | 59.20%   | 2019 <sup>8</sup>  |
| Shkalla e punësimit të të rinjve                                            | 41.2%  | 35.70% | 46.60%   | 2019 <sup>8</sup>  |
| Të rinjtë që themeluan biznesin e tyre me mbështetjen financiare të shtetit | 26%    |        |          | 2019 <sup>10</sup> |
| Të rinjtë e vetëpunësuar                                                    | 7.8%   | 6.00%  | 9.70%    | 2019 <sup>3</sup>  |

[9] Kërkesë për informacion Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë  
[10] Që nga viti 2018, metodologjia për llogaritjen e numrit të të rinjve të vetëpunësuar të regjistruar ndryshoi. Ky indikator llogaritet duke pjesëtuar numrin e të rinjve të vetëpunësuar të regjistruar me popullsinë e të rinjve.



---

“Norma e NEET është  
zvogëluar me 3.4%  
krahasuar me katër vjet  
më parë”

---

---

# Krahasimet e të dhënave gjatë 4 viteve të monitorimit

Në tërësi, disa indikatorë tregojnë një përmirësim të dukshëm krahasuar me të dhënat e raportuara katër vjet më parë, veçanërisht për pjesëmarrjen ekonomike të të rinjve.

Sa i përket pjesëmarrjes politike të të rinjve, shumica e indikatorëve ose janë përkeqësuar ose nuk kanë ndryshuar aspak. Numri i ministrave të rinj dhe ekzistenca e strukturave rinore në nivel kombëtar është 0% dhe nuk ka ndryshuar gjatë këtyre katër viteve. Treguesit e vetëm që janë përmirësuar janë numri i zëvendësministrave të rinj dhe numri i strukturave rinore në nivel lokal. Numri i strukturave rinore të krijuara në nivel lokal është rritur ndjeshëm me 39.4% krahasuar me katër vjet më parë. Ndërsa, numri i kryetarëve të rinj të bashkive është përkeqësuar në krahasim me vitin e kaluar duke arritur në 0% dhe numri i deputetëve të rinj është ulur me 0.9%. Gjatë këtyre viteve, numri i grave në poste ekzekutive dhe politike është rritur.

Për sa i përket pjesëmarrjes sociale, disa të dhëna kanë mbeten të pa përditësuara ose të pa matura siç janë numri i të rinjve të varfër, të rinjtë në rrezik varfërie dhe ata pjesë e sistemit të mbrojtjes sociale. Indikatorët në lidhje me arsimin tregojnë një përmirësim të vogël krahasuar me 4 vjet më parë. Braktisja e shkollës së mesme është ulur me 1.1% krahasuar me katër vjet më parë. Në të njëjtat linja, përqindja e të rinjve të regjistruar dhe të rinjve të diplomuar janë rritur përkatësisht me 2.7% dhe 5.22%. Indikatorit që ka shënuar një përmirësim të dukshëm është numri i të rinjve në burgje. Krahasuar me vitin 2018, numri i të rinjve në burgje është zvogëluar me 12.9%. Është e qartë se gratë e reja performojnë më mirë sesa burrat e rinj për sa i përket pjesëmarrjes sociale, ekskluzivisht në lidhje me arsimin.

Lidhur me pjesëmarrjen ekonomike të të rinjve, vihet re një përmirësim i dukshëm gjatë këtyre katër viteve, duke përmendur këtu se norma NEET u ul me 3.4%, papunësia e të rinjve u ul me 7.4% dhe papunësia afatgjatë e të rinjve u ul me 5.2%. Si pasojë, të dhënat mbi pjesëmarrjen e forcës së punës së të rinjve dhe shkallën e punësimit të të rinjve janë rritur përkatësisht me 6.8% dhe 8.8%. Të dhënat për të rinjtë e vetëpunësuar janë rritur ndjeshëm krahasuar me vitin e kaluar<sup>11</sup> me 6.9%. Burrat e rinj duket se kanë një përfshirje më të lartë në tregun e punës sesa gratë e reja kur bëhet fjalë për shkallën e punësimit të të rinjve, pjesëmarrjen e forcës punëtore të të rinjve, shkallën e papunësisë së të rinjve, normën NEET dhe vetëpunësimin. Nga ana tjetër, gratë e reja kanë një normë më të ulët të papunësisë afatgjatë të të rinjve, i cili është indikatorit i vetëm që tregon një performancë më të mirë të grave krahasuar me burrat në këtë dimension.

[11] Që nga viti 2018, metodologjia për llogaritjen e numrit të të rinjve të vetëpunësuar të regjistruar ndryshoi. Ky indikator llogaritet duke pjesëtuar numrin e të rinjve të vetëpunësuar të regjistruar me popullsinë e të rinjve.

# Rekomandimet për politika dhe çështjet e advokimit

Sesioni tjetër ofron disa rekomandime për politika në secilin dimension, të cilat duhet të adresohen nga institucionet dhe aktorët që punojnë në fushat përkatëse.

Në vitin e katërt radhazi të monitorimit, mungesa e të dhënave statistikore mbi pjesëmarrjen sociale të të rinjve mbetet ende një problem.

## PJESËMARRJA POLITIKE E TË RINJVE

- Pavarësisht shumë pengesave dhe çështjeve të diskutueshme që përmbante projektligji për Rininë, ai u miratua në fund të vitit 2019. Këshilli Rinor Kombëtar nuk është akoma në fuqi dhe pritët të krijohet gjatë vitit 2020.
- Për shkak të projekteve të implementuara nga organizatat e shoqërisë civile, numri i bashkive që kanë krijuar struktura rinore është rritur ndjeshëm. Pritët që zbatimi i ligjit të imponojë krijimin e strukturave rinore në bashkitë e tjera, të cilat nuk kanë akoma një strukturë rinore. Sidoqoftë, shumica e strukturave rinore tashmë të krijuara duhet të jenë më aktive dhe të promovojnë punën e tyre për tërë spektrin e aktorëve të interesuar në qytet.
- Si pasojë e ngjarjes më të fundit politike gjatë vitit 2019, në të cilën partitë e opozitës dhanë dorëheqjen nga mandatet e tyre politike dhe vendosën të mos merrnin pjesë në zgjedhjet lokale të mbajtura në qershor, pjesëmarrja politike e të rinjve për vitin 2019 u përkeqësua. Përqindja e kryetarëve të rinj të bashkive u zvogëlua nga 6% në 0%, si dhe përqindja e deputetëve të rinj u ul me 0,9%. Zgjedhjet në nivel qendror do të mbahen gjatë vitit 2020 në Shqipëri. Ky është një moment që duhet të përdoret nga partitë politike për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve në demokraci dhe proceset vendimmarrëse duke promovuar deputetë të rinj.
- Për sa i përket mjeteve online të përdorura për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrje si në nivelin kombëtar ashtu edhe në atë lokal, vërehet se shumë faqe të mediave sociale ose nuk funksionojnë, ose nuk ofrojnë informacion të mjaftueshëm. Ministritë dhe bashkitë duhet të përditësojnë llogaritë e tyre në mediat sociale dhe faqet e internetit, si dhe të ndajnë më shumë informacion me qytetarët dhe t'u ofrojnë atyre mundësinë për të marrë pjesë në aktivitete dhe procese të ndryshme.

## PJESËMARRJA SOCIALE E TË RINJVE

- Duke marrë parasysh pengesat e krijuara nga fatkeqësitë natyrore të tilla si tërmetet dhe situata pandemike, të rinjtë e marginalizuar mbeten të përjashtuar nga shoqëria. Së pari, institucionet arsimore duhet të investojnë më shumë në këtë grup të synuar në mënyrë që të mos i lënë ata pas dhe të rrezikojnë nivele të larta të braktisjes së shkollës.
- Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme duhet të organizojnë më shumë aktivitete jashtëshkollore në përfshirje të të rinjve duke rritur aftësitë e tyre sociale dhe duke përmirësuar aktivizmin e tyre në komunitet.
- Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet shërbimit të këshillimit të karrierës, veçanërisht kurrikulës që duhet të prezantohet duke filluar nga arsimi fillor. Këshillimi i karrierës duhet të ofrohet jo vetëm në universitete, por edhe në shkollat e mesme duke synuar orientimin e të rinjve në arsim dhe rrugëtim profesional në përputhje me interesat, ambiciet dhe aftësitë e tyre. Ekziston nevoja për më shumë hapësira publike kushtuar aktiviteteve kulturore dhe sportive për të rinjtë, veçanërisht jashtë Tiranës.
- Edhe pse numri i të rinjve në burgje është zvogëluar në vitin 2019, nevoja për të krijuar programe të përshtatura të riintegritimit për të rinjtë në burgje<sup>12</sup> mbetet. Këto programe synojnë t'i përgatisin ata për jetën jashtë burgut duke i pajisur me aftësi të nevojshme për tregun e punës.

## PJESËMARRJA EKONOMIKE E TË RINJVE

- Një çështje tjetër advokuese është ulja e nivelit të lartë të nivelit të normës NEET dhe shkallës së papunësisë së të rinjve përmes forcimit të mekanizmave për akses në punë në mënyrë që të përmirësohet mospërputhja midis kërkesës dhe ofertës në tregun e punës. Mjetet e këshillimit të karrierës të tilla si sesionet tematike në shkolla, këshillimet individuale, diskutimet në grupe, testet e çertifikuara dhe platformat që ofrojnë punë, trajnime dhe ofertë arsimore për të rinjtë janë shumë të rëndësishme.
- Shteti siguron fonde për sipërmarrjet e themeluara nga të rinjtë vetëm përmes Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve. Më shumë akses në financa duhet t'u sigurohet sipërmarrësve të rinj nga qeveria qendrore dhe lokale. Për më tepër, informacioni duhet të jetë i aksesueshëm nga të gjithë të rinjtë që jetojnë në zona urbane dhe rurale.
- Ekzistojnë disa programe trajnimi ose këshillimi për sipërmarrësit e rinj dhe disa skema të vogla financiare që synojnë fillestarët. Sidoqoftë, ekziston nevoja për shërbime profesionale inkubatore dhe përsheptuese të cilat duhet të ofrojnë paketa të plota me kosto të ulët për të rinjtë. Këto paketa duhet të përfshijnë aksesin në fonde, programet e trajnimit dhe mentorimit, mundësitë e rrjetëzimit, ekspozimin në tregjet ndërkombëtare, business angels dhe skemat e investimeve. Duke qënë se ekziston një hendek midis sipërmarrësve femra dhe meshkuj, skemat financiare dhe programet e zbatuara duhet të synojnë qëllimisht gratë e reja në mënyrë që të rrisin aspiratat e tyre sipërmarrëse.

[12] Përqindja e të rinjve në burgje llogaritet si numri i të rinjve në burgje i pjesëtuar me numrin e përgjithshëm të personave të burgosur në Shqipëri.



---

[www.partnersalbania.org](http://www.partnersalbania.org)

---

Partnerët Shqipëri  
për Ndryshim dhe Zhvillim

Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate,  
kati 10, ap. 71/73, Tiranë 1019 Tirana,  
Albania

Projekti WB&T for EmploYouth po zbatohet nga:



**PARTNERËT SHQIPËRI**  
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

